

BIBLIOTEKA
SHTETIT

SH-SR
961

Ahmet
Golemi

novelë



**PËR BINDSHI
I BARDHË**

844-52
861

AHMET GOLEMI

R

PËR BINDSHI I BARDHË

— Novelë —



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

I

Në moshën trembëdhjetëvjeçare, babai më kishte marrë me vete për të parë ndeshjen e boksit ndërmjet amerikanit Vismar dhe gjermanit Shmajk. Gjatë ndeshjes u entuziazmova dhe, në fund, kur Vismari, në mes të përshëndetjeve të pashembullta që i drejtonin njerëzit, të cilët mbushnin sallën, u deklarua fitues, unë, duke brohoritur si një i madh, s'i ndaja sytë nga mesi i ringut, ku për disa minuta flamuri valvitej krenar sipër kokës së Haver Vismarit. Atëhere besova se gjëja më e rëndësishme në jetë do të ishte, për mua, marrja e titullit «Kampion botëror». Për vite me radhë u stërvita në palestrën e madhe të klubit «Kampionët e rinj». Nën drejtimin e mister Harryt ndiqja kokulur stërvitjen, djersitja shumë dhe në të njëjtën kohë duroja kërkesat e rrepta të regjimit sportiv. Fitoren e parë e arrita në Olimpiadën e Romës, ku, pa i mbushur akoma të tetëmbëdhjetat, solla në atdhe dy dhurata simbolike: medaljen e artë të kampionit dhe atë të boksierit më të mirë. Po, kur u ktheva, unë, që në kanotierën time mbaja stemën e kombit tim dhe që për fitoren time flamuri amerikan u valvit gjatë në shtizën

e lartë të sallës, nuk kisha të drejtë të hyja e të kremtoja këtë fitore në një nga lokalet kryesore të Nju-Jorkut. Dhe kjo vetëm se unë, të afërmit dhe shokët e mi që më shoqëronin, nuk ishin të bardhë. Atëhere kuptova se gjëja më e rëndësishme s'ishte ajo që besoja! Të fitoje të drejtën për t'u futur në lokalet ku hynin vetëm të bardhët ishte më e rëndësishme se fitorja e medaljes së artë, bile dhe më e rëndësishme se mbajtja e gjerdanit të artë të kampionit të botës në boksion profesionist.

Salla ku zhvillohej stërvitja gumëzhinte nga thirrjet e tifozëve të Klajdit e të Xhejmsit, kampionë të botës për peshën e rëndë. Këto thirrje të krijonin përshtypjen se në ring po zhvillohej një ndeshje e vërtetë dhe jo një ndeshje sparingu¹). Të gjithë kishin paguar për të qenë të pranishëm në stërvitjen e fundit të Klajd Klemerit, para se të ndeshesh me Xhejms Frizlandin. Dhe të gjithë e ndjenin se ishin elektrizuar në sallën kur Klajdi kishte marrë mësimet e para dhe më vonë kishte kalitur veten për t'u bërë sfidë gjithë kampionëve të botës, paraardhës të tij; dhe, më pas akoma, për të përmbysur krejt papritur famën e Pjerrsonit, si kampioni me një forcë fenomenale, të cilin Klajdi, në ndeshjen për marrjen e titullit, e detyroi ta linte lojën në raundin e dhjetë. Të gjithë i mbërthenin vështrimet e tyre të etura herë te ringu i ngritur në mes të sa-

1) Sparing — ndeshje stërvitore me një ose më shumë kundërshtarë — partnerë.

llës, herë te «katërshja» që kishte zënë vend fare pranë ringut.

Në ring, si përherë, i fuqishëm dhe krenar, Klajdi ndeshet me partnerët e tij; Klajdi, që kishte ndezur në mendjen e specialistëve të sportit të boksit një zjarr të madh në të cilin digjeshin të gjitha shpresat për t'i dalë një kundërshtar që t'i rimerrte titullin; Klajdi, që kishte bërë të mblidheshin në një konferencë të gjithë hipnotizuesit më të mirë, për të vërtetuar nëse kampioni i ri zotëronte aftësi hipnotizuese dhe nëse, në sajë të tyre, i impononte çdo kundërshtari humbjen e sigurtë; Klajdi, që kishte habitur të gjithë boksierët e botës me thënjen e tij: «Unë nuk mund të shoh gjak në ring»; Klajdi, që kishte ndezur fantazinë e sipërmarrësve sportivë me grushtin e tij «Faust», i cili, pas çdo ndeshjeje, sillte një fitim prej afro dy milion dollarësh; Klajdi, që me fjalimet e tij të zjarra për të drejtat e zezakëve dhe kundër diskriminimit racial, kishte tërbuar nazistët e bardhë, duke ua shembur të gjitha shpresat për të gjetur një boksier të bardhë që t'i mbyllte gojën kampionit të zi «gojështhurur», dhe së fundit, Klajdi, që nuk kishte pranuar të shkonte ushtar në Vietnam dhe që kishte shqetësuar gjeneralët e Pentagonit. Ishte Klajd Kleméri që kishte hyrë në zemrat e miliona e miliona njerëzve me ngjyrë, të ndershëm e përparimtarë, në të katër anët e botës.

Herë-herë tifozët dhe dashamirësit, me vështrim të ndezur lexonin nëpër muret e larta parulla të shkruara me drita neoni: Xhejmsi është uzurpator» — «Klajdi është kampion i vërtetë» — «Klajdi është fitimtar» — «Xhejmsit i duhet dhënë një mësim i mirë».

Dhe vërtet, në këto katër parulla ishte përmbled-

dhur i gjithë debati që po zhvillohej akoma nëpër faqet e revistave dhe të gazetave, nëpër altoparlantët e radiove dhe në ekranët e televizorëve. Dhe në mendjen e të gjithëve, si një pikëpyetje e madhe, ishte shtruar pyetja: «Kush do të fitoj?»

Të parët, tifozë të Klajdit, pothuajse të gjithë zezakë, ishin për fitoren e boksierit të tyre. Ata kishin besim se kohën e shkurtër që i kishte mbetur për të dalë përsëri në ring, Klajdi e kishte shfrytëzuar seriozisht dhe me një këmbëngulje të madhe. Ndaj me zë të lartë thërrisnin: «Klajd, Klajd!» si të donin të thoshin me shqetësimin e tyre: «Ej, Klajd! Kjo është stërvitja e fundit, ndaj tregoju tifozëve të Xhejmsit forcën tënde...»

Të dytët, pothuajse të gjithë të bardhë, ishin shumë të kënaqur. Në kohën që Klajdi kishte qenë në burg për të vuajtur dënimin që i dha gjykata ushtarake, pasi nuk pranoi të shkojë ushtar në Vietnam, Xhejmsi i tyre ishte stërvitur sa s'ka më mirë dhe tani, para ndeshjes me Klajdin, tregonte një përgatitje të shkëlqyer. Ata hetonin me durim nëse Klajdi ndodhej me të vërtetë në formë të mirë, ashtu siç kishte deklaruar ditët e fundit «katërshja» që drejtonte stërvitjen e tij. Pastaj, duke ndjekur me kureshtje sparingun që po zhvillonte Klajdi, pa e përmbajtur dot kënaqësinë që ndjenin, bërtisnin: «Xhejms, kampion i vërtetë! Klajdi do të puthë tapetin...»

Grupi i tretë i dashamirësve turistë ndiqte me vëmendje lëvizjet dhe goditjet e Klajdit gjatë sparingut, dhe në pushimin e raundeve e kalonte vështrimin herë te gerrat e neonit shkruar në muret e larta të sallës, herë te Klajdi, si të donte të vinte

në njërën anë të peshores forcën sportive të Klajdit dhe në tjetrën domethënien e germave...

Kush me keqardhje, kush me ironi e kush me mosbesim, të tre grupet drejtonin shikimet e tyre kuptimplote nga «katërshja» që qe ulur në stolin e meshintë, fare pranë qoshes ku Klajdi kryente minutën e pushimit. Sipërmarrësi, avokati, doktori dhe treneri mundoheshin të fshihnin diçka që nuk shkonte midis tyre. Këtë diçka ata mundoheshin t'ja fshihnin edhe vetes, edhe tifozëve, edhe dashamirësve që i rrethonin nga të katër anët. Dhe kjo «diçka» ishte se, gjatë ndeshjes-sparing, shpeshherë Klajdi i vinte fre forcës dhe shkathtësisë së tij. Në këto çaste jo të favorshme për të, ai dukej sikur këshillohej me veten dhe pastaj, si ta kuptonte gabimin për këtë shmangie, niste të godiste... Ç'të kishte vallë Klajdi, që, me stërvitjen e tij të fundit, shqetësoi shumë tifozët dhe «katërshen» besnike, krijoi mosbesim te dashamirësit dhe kënaqi egon e sëmurë të tifozëve të Xhejmsit? Mos vallë gjatë raundeve të shumtë atij i vinte keq të godiste fort e vazhdimisht shokët e tij të afërt, që në ring po luanin rolin e partnerit? Apo ndodhte e kundërta? Mos vallë atij nuk i mjaftonin energjitë fizike dhe morale që të godiste fort, shumë fort dhe pa ndërprerje gjatë gjithë raundeve? Mos vallë e bënte me qëllim që të kënaqte tifozët e Xhejmsit dhe bashkë me ta edhe vetë sedrën e Xhejmsit? Apo kërkonte të ruante energjitë për ndeshjen e vërtetë?

Po pse nuk mendonte atëherë për dëshpërimin që po u shkaktonte tifozëve të tij? Përse nuk ngulte këmbë të vinte në jetë këshillat e trënierit: të bënte çmos për t'i mbajtur partnerët sa më larg dhe së fundi, po të mos mundte, edhe në gjysmë largësi?

Po udhëzimet që i dha doktori? «Ti, Klajd, gjatë sparingut, do t'i harxhosh të gjitha energjitë që ke fituar, që pastaj të mund të llogarisim gjithshka, edhe në hollësitë më të vogla, për luftimin taktik me Xhejmsin». Po, sipërmarrësi dhe avokati, që ju lutën të mos hezitonte në sparingun e fundit, pasi duhej të justifikonin para të pranishmëve deklaratat e tyre të bujshme! Shumë pikëpyetje për të gjithë...

Dhe ja, midis pëshpëritjeve, heshtjes dhe të thirrurave shurdhuese, që nga fundi u bënë të papërmbytura, u dëgjua tingulli i rrëqethës dhe i zgjatur që nxori rënja e gongut. «Katërshja» që drejtonte stërvitjen e fundit, u ngrit në këmbë. Por thirrja e ethshme dhe nervoze «No! No!» e Klajdit, i cili, i stepur nga ndërprerja e parakohshme e sparingut, që kthyer nga «katërshja» me krahët e tendosur, i detyroi ata të ulen të hutuar në stolin e meshintë. Britma e zgjatur e Klajdit e bëri sallën të heshtë për një çast. Të gjithë e kuptuan se ajo ngjante me britmën e një njeriu të porsazgjuar nga një ëndërr e zyrtë.

Heshtja zgjati disa sekonda. «Katërshja», që ishte ngritur përsëri në këmbë, urdhëroi prerë që sparingu të ndërpritej. Atëhere Klajdi, i shtrëngoi të dy grushtet fort dhe goditi me nervozizëm jastëkun e qoshes, si të donte të thoshte: «Pse s'më lejoni tani?».

Salla e stërvitjes, që ngjante me një folë grerëzash, këtë radhë u nemit dalëngadalë, derisa u qetësua e tëra.

— Qëndro, Klajd! — thirri sipërmarrësi.

— Kthehu, Klajd! — përsëriti avokati.

— Ah, Klajd, s'bën mirë kështu! — e këshilloi doktori.

Por Klajdi vrapoi dhe, duke mbajtur fort veshët me dorezat e hapura, u fut me nxitim në dhomën e tij. Instinktivisht, të katër ata, të shoqëruar nga vështrimet shqetësuese të partnerëve dhe të masazherit, shkuan në drejtim të dhomës së Klajdit. Pastaj, si t'i urdhëronte ndokush, ata ndalën, pa ditur se ç'të bënin.

— Po ne, a s'jemi vetë Klajdi? — tha sipërmarrësi. — Përse ta trondisim? A s'jemi ne, mendi mi, forca dhe shëndeti i tij? Ç'mund të na thotë ai më tepër nga ato që dimë dhe themi ne për të? — Dhe sipërmarrësi u drejtua për nga dhoma e tij. Tre të tjerët i shkuan pas.

— Duhet të kisha ngulur këmbë që sparingu i sotëm të bëhej pa dëshmitarë të jashtëm, — tha si me vete sipërmarrësi, duke u lëshuar në kolltukun e meshintë. Tre të tjerët u ulën rreth tij.

— Do të kishte si pasojë enigmën, dyshimin dhe mosbesimin, — u përgjegj shpejt avokati, si ta kishte ai radhën për të folur.

— Po kjo, — dhe sipërmarrësi bëri me kokë nga salla, — ç'pasoja ka?

— Çdo gjë ka shkuar sipas parashikimeve, — tha doktori. — Të ishte stërmundimi si faktor i vetëm, do të kishte dhe shfaqje të tjera.

— Ju raportuat në mëngjez, pas vizitës së zakonshme, se Klajdi ka pagjumësi, — ndërhyri avokati si për të lehtësuar veten.

— Oreksi nuk i është prerë, — foli shpejt doktori për t'i bindur të tjerët. — Ju e dini mirë që pagjumësia e stërmundimit shoqërohet me debolesë dhe me mungesë oreksi.

— Po hezitimet në ndeshjen e sparingut, po shpeshherë mbrojtja e gjatë pasive, moslëvizshmëria

elastike e këmbëve dhe kundërgoditjet e vonuara, a nuk janë këto veshja e jashtme e debolesës, — foli me ngadalë, po me ton të rreptë sipërmarrësi.

— Mos harroni veshjen e brendshme të saj, — u mbrojt shpejt doktori.

— Do të thuash për betejën e gjatë psikologjike, për goditjet në botën e tij shpirtërore, për shkallën e ulët të moralit të tij, — ju kthye avokati.

Sipërmarrësi e doktori ja ngulën sytë pa folur, si të donin të thoshin: «Harrove ti, i dashur Majk, se Klajdi ynë nga natyra është shumë i ndjeshëm!»

— Ju e dini mirë se unë kërkova me ngulm që ndeshja me Xhejmsin të zhvillohej kudo, në çdo vend tjetër të botës, vetëm në Amerikë, jo!

Sipërmarrësi dhe doktori s'ja ndanin sytë avokatit. Vështrimet e tyre të vrejtura thoshin: «Kur e dije, i dashur Majk, se ndeshja me Xhejmsin do të zhvillohej patjetër në Amerikë, përse atëhere nuk e ngrite zërin e arësyes?»

Tani avokati kishte marrë një pamje të dëshpëruar, si njeriu që provon një humbje të papritur. Ata të tre nuk e vunë re, se treneri, i cili gjer tani s'kishte pipëtirë fare, u ngrit dhe, pa u ndjerë, hapi derën me xhama akulli dhe eci drejt korridorit plot dritë për të shkuar te Klajdi, nxënësi dhe djali i tij në shpirt.

— Po ju dini gjithashtu, — shtoi me ngulm avokati, — që unë, së bashku me «gardën tonë» të partnerëve, e mbajta Klajdin larg çdo takimi me njerëz të dyshimtë...

Sipërmarrësi, si të mos u vinte shumë rëndësi fjalëve të fundit të avokatit, nxori paketën dhe u ofroi cigare kolegëve të tij. Vetëm tani u kujtua për trenerin që s'ishte aty. U ndezën cigaret dhe të tre,